REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 01, datë 17/02/2005

"PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS NR.7. DT.07/03/2003 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS "

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ndryshuar me Ligjin Nr.9208, datë 18.03.2004, neni 10, neni 16, pika 2, 3 dhe 4, neni 32, gërma "f", Ligjit Nr. 8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore" ndryshuar me Ligjin Nr. 9325, datë 6.12.2004, neni 13, neni 21, gërma "a", neni 22 dhe neni 23, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 7, datë 07.03.2003 "Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

I. NË KAPITULLIN 1.1 "TAKSAT VENDORE", gërma "a.1" "*TAKSA MBI NDËRTESËN*",

- Pas fjalisë "Taksa mbi ndërtesën është një detyrim vjetor", shtohen paragrafet si më poshtë:

Për kategorinë "Ndërtesa banimi" dhe "Ndërtesa të tjera", në rastin kur mungon dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë, të dhënat për përllogaritjen e taksës të merren në bazë të vetëdeklarimit të llojit dhe sipërfaqeve të pasurisë nga qytetarët dhe taksapaguesit e tjerë.

Afati i vetëdeklarimit për qytetarët dhe për subjektet fizikë e juridikë është deri në muajin Mars të vitit, me përjashtim të vitit 2005, kur vetëm për kategorinë "Ndërtesa banimi" afati është deri në muajin Qershor të vitit.

Vetëdeklarimi është detyrues për këto raste:

- për vitin 2005
- për subjektet fizikë, juridikë dhe qytetarët që nuk deklarojnë gjatë vitit 2005 janë të detyruar të vetëdeklarojnë në vijim
- në rastet kur ka ndryshime në të dhënat e vetëdeklaruara në formularin e mëparshëm.

Formulari i vetëdeklarimit dorëzohet brenda afatit të përcaktuar nga qytetarët pranë Agjentit Tatimor "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a dhe nga personat fizikë dhe juridikë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Në mungesë të të dhënave si rezultat i mosdeklarimit sipas afateve të përcaktuara si më lart dhe/ose në mungesë të dokumentacionit të pronësisë për subjektet taksapaguese të Kategorisë "Ndërtesa të tjera", llogaritja e detyrimit bëhet:

- për kategorinë "Ndërtesa banimi", mbi bazë fikse, ku madhësia e sipërfaqes së taksueshme është si më poshtë:

1. Për ndërtesat e banimit të ndërtuara para vitit 1993 sipërfaqja e taksueshme është 100 m2.

2. Për ndërtesat e banimit të ndërtuara mbas vitit 1993 sipërfaqja e taksueshme është 200 m2.

- për kategorinë "Ndërtesa të tjera" sipërfaqja e taksueshme vendoset në bazë të vlerësimit fizik, nga një komision i posaçëm pranë organit tatimor.

- Paragrafi i tretë "Detyrimi vjetor i taksapaguesit ndahet ..." ndryshon dhe riformulohet si më poshtë:

Detyrimi vjetor i taksapaguesit ndahet në 2 këste të barabarta. Kësti i parë paguhet për kategorinë "Ndërtesa banimi" brenda datës 30 Qershor të vitit, ndërsa për kategorinë "Ndërtesa të tjera" brenda datës 31 Mars të vitit dhe kësti i dytë për të dy kategoritë brenda datës 30 Shtator të vitit.

Për vitin 2005, vetëm për kategorinë "Ndërtesa banimi" afati i pagesës së kështit të parë është muaji Shtator 2005 dhe afati i pagesës së kështit të dytë është muaji Nëntor 2005.

II. NË KAPITULLIN 1.1 "TAKSAT VENDORE", germa "e", "*TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE*", *ndryshon si më poshtë:*

Baza e taksës për zënie të hapsirave publike është sipërfaqja në m2, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte me qëllime të aktivitetit tregtar.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të kësaj Takse janë si më poshtë:

Taksa për zënien e hapësirave publike

Kategoritë dhe nënkategoritë		**Niveli tregues i Taksës**			
		Zona A	**Zona B**	**Zona C**	**Koeficienti**
I	**Zënie e hapësirës publike (përdorim trualli)**	**30 lek/m2/ditë**	**25 lek/m2/ditë**	**20 lek/m2/ditë**	
-	**Mallra jashtë vendit të tregtimit (deri në 1 metër)**				**1**
-	**Vende tregtimi shtypi, librash etj**				**1.25**
-	**Vende tregu publik**				
	- fruta perime				**1.5**
	- bulmet, mish, peshk				**2**
	- artikuj industrial				**1**
-	**Tregtarë jashtë tregjeve publikë**				**2.5**
-	**Spektakle ose panaire të ndryshme - cdo dite**				
	- nga 1 deri 100 m2				**1**
	- nga 101 deri 1000 m2				**0.5**
	- mbi 1000 m2				**0.25**
-	**Objekte të përkohshme me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar**, ***sipërfaqet e zëna me platforma ndertimore, siperfaqe te rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drure dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera***				**1**
II	**Zënie e hapësirës publike (për qëllime reklamimi)**	**30 lekë/m2/ditë**	**25 lekë/m2/ditë**	**20 lekë/m2/ditë**	
-	Reklamë e zakonshme				**1**
-	Reklamë e përbërë				**1.25**

-	Reklamë elektronike				**1.5**
-	Tenda reklamuese	**100 lekë/m2/muaj**	**70 lekë/m2/muaj**	**50 lekë/m2/muaj**	

Në rast të shfrytëzmit të hapësirës publike për qëllime tregtare me objekte si tavolina, që nuk kategorizohen në tabelën si më lart, përllogaritja e taksës bëhet sipas nivelit:

Zona A	50 lekë/tavolinë/ ditë
Zona B	40 lekë/tavolinë/ ditë
Zona C	30 lekë/tavolinë/ ditë

Detyrimi i taksës përllogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj, duke aplikuar koefiçientin përkatës.

Vetëm për Kategorinë II , nënkategoria "Tenda reklamuese", detyrimi i taksës i takon subjektit reklamues. Ky detyrim mbahet nga subjekti, në hapësirën e të cilit është vendosur tenda reklamuese për llogari të Bashkisë së Tiranës.

Pagesa e Taksës për zënie të hapësirës publike bëhet:

- për kategorinë **I,** me përjashtim të nënkategorisë "*zënie e hapësirave publike për spektakle ose panaire të ndryshme* "; për nënkategorinë "Tenda reklamuese" në Kategorinë **II,** si dhe kur llogaritja bëhet për tavolinë, detyrimi është mujor dhe pagesa bëhet brenda datës 15 për muajin përkatës.
- Për Kategorinë **I**, nënkategoria "*zënie e hapësirave publike për spektakle ose panaire të ndryshme* " pagesa do të bëhet me marrjen e Lejes për Ushtrimin e Aktivitetit për të gjithë detyrimin e llogaritur në bazë të kohëzgjatjes së aktivitetit.
- Për kategorinë **II,** detyrimi është vjetor dhe pagesa behet me 2 këste. Pagesa e kështit të parë do të bëhet deri në datën 31 Mars dhe e kështit të dytë deri në datën 30 Shtator të vitit.

Taksapaguesit e Kategorisë (I) dhe (II) përfitojnë kushte lehtësues kur :

<u>Kategoria I</u>

- lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 6-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 5% të vlerës së detyrimit.
- lidhin kontratë për zënie të hapësirës publike me afat 12-mujor dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së saj, përfitojnë reduktimin në masën 10% të vlerës së detyrimit

<u>Kategoria II</u>

- paguajnë të gjithë vlerën e detyrimit tatimor vjetor brenda 3/mujorit të parë të vitit, përfitojnë reduktimin në masën prej 10 % të vlerës së detyrimit.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës për zënien e hapësirës publike është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Vetëm për nënkategoritë "Vende tregu publik" dhe "Tregtarë jashtë tregut publik" të Kategorisë I, agjent tatimor për mbledhjen e Taksës për zënien e hapësirës publike janë Njësitë Bashkiake, sipas vendndodhjes për çdo treg, të cilat përfitojnë 20 % të të ardhurave të arkëtuara.

III. NË KAPITULLIN 1.1 "TAKSAT VENDORE" mbas gërmës "ë" "*TAKSA E TABELËS"* shtohet gërma "f" me këtë përmbajtje:

"f) TAKSA E GJELBËRT (E PËRKOHSHME PËR VITET 2005-2006)

Taksës së gjelbërt i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Taksës së përkohshme për gjelbërimin janë si më poshtë:

Kategoritë		**Niveli i Taksës**	**Niveli i Taksës Sipas llojit të aktivitetit**	
			Biznes i Vogël	**Biznes i Madh**
I	**Çdo Familje**	**200 lekë/vit**	**lekë/vit**	**lekë/vit**
II	**Veprimtari ekonomike të veçanta**			
-	*Njësi prodhimi:*			
	-prodhim, përpunim ëmbëlsirash dhe produktesh ushqimore		4000	9000
	-prodhim, përpunimi pijesh		4000	9000
	-prodhim përpunim druri, mobileri, tapiceri		4000	9000
	-impiante, prodhim dhe përpunim metalesh		4000	9000
	-prodhim, përpunim, tregtim materialesh inerte		4000	9000
	-prodhim, perpunim qumështi dhe nënproduktesh		4000	9000

	-prodhim konfeksionesh		4000	9000
	-prodhim, përpunim i letrës, kartonave , plastmasit		4000	9000
	-prodhim, përpunim vajrash, naftë, gazi dhe nënproduktesh		4000	9000
	-impiante, territore per therrjen e kafshëve		4000	9000
	-prodhim, përpunim produktesh farmaceutike		25000	100000
-	*njësi-çdo kantier ndërtimi*		25000	100000
-	*Njësi shërbimi:*			
	-Klinika mjeksore, laboratore		7000	10000
	-Bar- Restorantet,		7000	10000
	-Fast-Food		5000	7000
	-Njësi Shërbim Non-Stop (Pub, Diskotekë etj)		10000	12000
	- Hotelet		10000	12000
III	**Njësi të tjera (që nuk përfshihen në kategoritë dhe nënkategoritë si më lart)**		**2500**	**5000**

Detyrimi për Taksën e gjelbërt është vjetor. Kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit.

Afati i shlyerjes së detyrimit është 3-mujori i parë i vitit.

Për nënkategorinë “Njësi-çdo kantier ndërtimi”, për efekt të llogaritjes së detyrimit nga taksa konsiderohet ngritje e kantierit të ndërtimit momenti i dorëzimit të formularit të lejes së ndërtimit, kërkuesit dhe përfundim punimesh konsiderohet kërkesa për Leje Shfrytëzimi (në çdo rast, mbas Aktit të kontrollit përfundimtar të punimeve).

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës së përkohshme për gjelbërimin është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Vetëm për kategorinë **I** “Familjet” Agjenti tatimor është “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a, Tiranë, i cili përfiton 3 % të shumës së arkëtuar.

IV. NË KAPITULLIN 1.2 "TARIFAT VENDORE", gërma "a" *"TARIFAT E REGJISTRIMIT PËR VEPRIMTARI TË NDRYSHME"*, ndryshon:

Tarifa e regjistrimit për veprimtari të ndryshme përbën detyrimin që duhet paguar në momentin e regjistrimit të subjekteve të reja taksapaguese. Kjo tarifë paguhet vetëm një herë, në momentin e kryerjes së regjistrimit fillestar të subjektit dhe veprimtarisë ekonomike pranë organit tatimor vendor.

Kategoritë dhe nivelet e tarifës së regjistrimit janë si më poshtë:

Kategoritë	**Tarifa në lekë**
Për veprimtaritë private të personave fizikë ambulantë	**2.000**
Për personat fizikë, shtetërorë e privatë, vendas e të huaj	**7.000**
Për personat juridikë, shtetërorë e privatë, vendas e të huaj	**12.000**

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së regjistrimit për veprimtari të ndryshme është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

V. NË KAPITULLIN 1.2 "TARIFAT VENDORE", gërma"b" "*TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE"*,

- Pika 1 ndryshon si vijon:

1. Për çdo familje 1.000 lekë (viti 2005)
1.400 lekë (viti 2006)
2.100 lekë (viti 2007 e në vijim)

- Mbas fjalisë" 11. Për të gjithë personat që klasifikohen si ambulant....." shtohet paragrafët si vijon:

Detyrimi për Tarifën e Pastrimit dhe Largimit të Mbeturinave është detyrim vjetor.

Detyrimi vjetor i taksapaguesit për Familjarët ndahet në 2 këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 30 Qershor të vitit dhe kësti i dytë brenda datës 30 Shtator të vitit**.**

Për të gjithë subjektet e tjera detyrimi paguhet brenda datës 31 Mars të vitit, për të cilët kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit paguajnë 50 % të tij.

VI. NË KAPITULLIN 1.2 "TARIFAT VENDORE", gërma "c" *TARIFA E REGJISTRIMIT PËR VENDBANIMIN E RI*, shfuqizohet.

VII. NË KAPITULLIN 1.2 "TARIFAT VENDORE", gërma "ç" "*TARIFA E PARKIMIT TË AUTOMJETEVE"*,

- Pika 3 ndryshon si më poshtë vijon:

3. Autoveturat

-Shtetërore dhe private	Zona A	100 lekë/orë
	Zona B	40 lekë/orë
	Zona C	20 lekë/orë

Për subjektet që kërkojnë parkim të rezervuar pranë institucioneve të tyre publike ose private tarifa përllogaritet duke shumëzuar vlerën sipas zonës së parkimit me koefiçientin 0.7 për rezervim 6-mujor dhe koefiçientin 0.5 për rezervim 12 mujor.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së Parkimit të Automjeteve është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës, e cila llogarit detyrimin dhe ndjek pagesat e tarifës së parkimit, pasi subjekti ka marrë lejen përkatëse nga Drejtoria e Transportit në Bashkinë e Tiranës.

Për vitin 2005 aplikimi i Tarifës së Parkimit në nivelet si më lart fillon 6-mujorin e dytë të vitit.

VIII. NË KAPITULLIN 1.2 "TARIFAT VENDORE", gërma "d" *TARIFA E REKLAMËS*, shfuqizohet.

IX. NË KAPITULLIN 1.2 "TARIFAT VENDORE", në gërmen "ë" *"TARIFA PËR NJËSITË BASHKIAKE"*,

- Pas fjalisë "përgatitja dhe kontrolli i dokumentacionit për përfitimin e statusit si i pastrehë..." shtohen fjalitë:

- tarifë për formularin e vetëdeklarimit për legalizim të ndërtimit pa leje në zona informale (e përkohshme, sipas afateve të vetdeklarimit) 200 lekë

- tarifë për regjistrim fillestar në biblioteka 100 lekë

X. NË KAPITULLIN 1.2" TARIFA VENDORE" pas gërmës "ë" shtohet gërma "f" si vijon:

"f) TARIFA TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË:

f.1 DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.1 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

- Tarifa për largimin e mbeturinave voluminoze (inerte, dhera, skeletike etj) 1800 Lekë / ton

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është Drejtoria Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit.

f.2 DREJTORIA NR.3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

- Tarifa për vërtetime 200 lekë
- Tarifa e plotesimit te dokumentacionit për privatizim 500 lekë

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Drejtoria Nr.3 e Puntorëve të Qytetit.

f.3 TEATRI I CIRKUT

- Tarifa e dhënies në përdorim të sallës 10.000 lekë/ orë

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës është Teatri i Cirkut

f.4 KLUBI SPORTIV TIRANA

- Tarifë e përdorimit të fushave të tenisit 300 lekë/orë
- Tarifë e përdorimit të palestrës 1.500 lekë/orë
- Tarifë e përdorimit të fushave të hapura të basketbollit 300 lekë/orë

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Klubi Sportiv Tirana

f. 5 QËNDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa :

	Kopshte	**Çerdhe**
Tarifë për Ushqimin	110 lekë/ditë/femijë	85 lekë/ditë/femijë

Detyrimi mujor përbëhet nga Tarifa fikse dhe Tarifa për Ushqimin, ku kjo e fundit përllogaritet me nivelin ditor të tarifës dhe ditët e frekuentimit të fëmijës në çerdhe/kopësht gjatë 1 muaji.

Përfitojnë reduktim të detyrimit mujor ose shërbim pa pagesë kategoritë e mëposhtme:

1. Familjet, të cilat kanë më shumë se 1 fëmijë në çerdhe dhe/ose kopshte:

1.1 për fëmijën e dytë 50 % reduktim nga detyrimi mujor
1.2 për fëmijën e tretë 100 % reduktim nga detyrimi mujor

2. Familje në nevojë si më poshtë përfitojnë shërbim pa pagesë:

2.1 Fëmijë me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda (sëmundje gjaku, sëmundje të brendshme), sipas raportit të Komisionit Mjeko-Ligjor.
2.2 Fëmijë të vajzave - nëna, sipas statusit në regjistrat e Gjendjes Civile.
2.3 Fëmijë të familjeve, ku kryefamiljare është gruaja e ve (sipas çertifikatës të gjendjes familjare), familjet ku kryefamiljare është gruaja e divorcuar(sipas çertifikatës të gjendjes familjare), por që është në/nën pagën minimale në shkallë vendi me dokumentacionin përkatës.
2.4 Fëmijë të familjeve ku kryefamiljari është më paaftësi fizike ose mendore sipas raportit të Komisionit Mjeko-Ligjor.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Qëndra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.

F. 6 NDËRMARRJA E PËRPUNIM PLEHUT

Tarifa për depozitimin e mbeturinave në fushën e Sharrës 95 Lekë / ton

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës është Ndërmarrja e Përpunim Plehut.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Njësitë Bashkiake dhe Institucionet e varësisë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI